



KOLEGJI ESLG

Veternik p.n., Prishtinë - Kosovë

Tel: +377 45 456 666 / +381 38 602 405

www.eukos.org

E-mail: info@eukos.org

PROCESVERBAL

- Sot me 07.07.2016 u mbajt Mbledhja e Komisionit për Botim dhe Hulumtim të Kolegjit ESLG në përbërje prej 6 anëtarëve si: Labinot Greiçevci, Sabiha Shala, Gjylbehare Murati, Jehona Hoxha, Sefer Avdijaj dhe Ferim Gashi. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Gjylbehare Murati, Jehona Hoxha, Sefer Avdijaj dhe Ferim Gashi.
 - Kjo është mbledhja e parë dhe ka zgjatur prej orës 18:15 deri në 19:40.
 - Në këtë Komision është diskutuar për inkurajimin e hulumtimit dhe botimeve në kolegjin ESLG.
 - Është propozuar tarifa me të cilën do të kompensohet stafi akademik në rast të shkrimit të ndonjë punimi shkencor në emër të ESLG-së, ose në rast të shkrimit të ndonjë libri, ku si botues është ESLG. Më pastaj ky propozim i dërgohet Bordit për aprovim.
 - Në këtë komision është diskutuar për Rregulloren e Temave të Diplomës për tu familjarizuar me validimin e programeve sllovene që nuk lejohen të bëhen ndryshime.
 - Gjithashtu, është diskutuar edhe për identifikimin e projekteve hulumtuese, në të cilat ESLG mund të aplikojë me stafin e vet akademik si dhe do të diskutojë lidhur me Research Guided Teaching, veçanërisht në programin master edhe bachelor. Kjo nënkupton që në kuadër të lëndëve që posedon ESLG-ja, mund të angazhohen studentët për të kryer hulumtime që mund të ju shërbejnë profesorëve për punimet e tyre shkencore që më pastaj mund të botohen në emër të ESLG-se.
- Rendi i ditës së Komisionit për Botim dhe Hulumtim**
- Inkurajimi i punimeve hulumtuese për studentë në kuadër të lëndëve Të gjithë anëtarët e komisionit janë dakorduar me idenë që të inkurajohen studentët dhe të gjendet një metodë e cila do t'i nxiste studentët që të merren me hulumtime. Në mes tjerash, ata kanë propozuar që të sigurohen sa më shumë

vizita në kuadër të lëndës. Gjithashtu kanë propozuar që si metodë për nxitjen e studentëve është që të ju publikohet temat e diplomës Njëri nga anëtarët e komisionit ka qenë kundër inkuadrimin të studentëve në hulumtime për shkak të natyrës së lëndës. Si propozim tjetër i anëtarëve është që studentët të inkurajohen në kuadër të seminareve dhe punimeve të temave të diplomës e jo të lëndës.

- **Inkurajimi i research-guided teaching në lëndët përkatëse;** Sa i përket pikës së dytë, është propozuar nga anëtarët e komisionit që profesorët të përdorin metoda më inovative të mësimdhënies për studentët me anë të metodave hulumtuese si dhe të motivohen më shumë studentët me punime seminarike, më shumë me punë grupore, dhe më pas të mos vlerësohen studentët si grup, por secili anëtarë ndaras veç e veç. Të gjithë anëtarët e Komisionit e kanë aprovuar këtë pikë, por kanë supozuar që të gjendet një metodë e ligjërimit e cila që do të mund të rriste interesimin e studentëve.
- **Punimet hulumtuese të shkruhen sipas rregullores së Kolegjit ESLG;** Të gjithë anëtarët e Komisionit janë pajtuar që të përpilohet një draft i shkurtër për përpilimin e punimeve seminarike të nxjerrë nga rregullorja e ESLG-së për përpilimin e temave të diplomës.
- **Caktimi i tarifave për kompensimin e stafit akademik në rast të botimit në ndonjë revistë shkencore;** Është propozuar që tarifat të caktohen në bazë të kategorisë së botimeve dhe revistave shkencore. Të inkurajohet stafi nga ana e Kolegjit për botimet e tyre në revistat shkencore në bazë të kategorizimit të botimeve duke u përpjekur që të gjendet një mekanizëm nga ana e ESLG-së.
- **Caktimi i tarifave për kompensimin e stafit akademik në rast të botimit të ndonjë libri me emër të Kolegjit ESLG;** Të krijohet një ide për krijimin e një instituti ku mund të inkurajohen studentët.
- **Themelimi i dy revistave shkencore brenda ESLG Journal of European Law dhe Journal of Real Estate and Energy Efficient Buildings;** Anëtarët e komisionit kanë propozuar që lidhur me aprovimin e kësaj pike duhet të marrin pjesë të gjithë anëtarët e komisionit, gjë që në këtë rast disa nga anëtarët nuk kanë qenë prezent. Ata kanë propozuar që një herë në vjet të organizohet një konferencë ndërkombëtare si në gjuhën shqipe ashtu dhe angleze, ndërsa prezantimi të bëhet vetëm në gjuhën angleze dhe revistat të botohen brenda Kolegjit ESLG,
- **Propozimi i anëtarëve të Bordeve Shkencore të revistave në fjalë vendor dhe ndërkombëtar.** Nuk është marrë ndonjë vendim për shkak të mos-pjesëmarrjes së anëtarëve të tjerë të komisionit.
- Është propozuar që mbledhjet të mbahen së paku tri herë në vjet.
- Takimi ka qenë më shumë informues, ndërsa vendimi për zgjedhjen është shtyrë deri në mbledhjen e radhës që parashihet të mbahet në muajin shtator.

Procesmbajtësi:

Jehona Hoxha

Hoxha



Prishtinë

07.07.2016

Gjylbehare Murati

Murati

FERIDA GASHI

Gashi

SEFER AVDIU

Avdiu

JEHONA HOXHA

Hoxha